REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorëzuar Primljeno/Predato Recieved/Delivery 29. 10 2018 viti god year			
Organ./Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr.Prot: Br.Prot: Prot.No:	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPHTHCM	6907/2018		1/3

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHTI BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A nr.651/2018

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Hajzer Salihu-kryetar, Lela Petkoviç dhe Shkëmb Manaj-anëtarë, me Sabile Avdyli-procesmbajtëse, kanë shqyrtuar ankesën me numër protokolli 5978/2018 të datës 15.10.2018, të parashtruar nga ankuesi Skender Beqiri nga fshati Koshare i Komunës së Ferizajt, në çështjen juridike "kompensim material" kundër organit të punësimit-Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 29.10.2018, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër protokolli 5978/2018 e datës 15.10.2018, e parashtruar nga ankuesi Skender Beqiri.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.2-1K/3535 i datës 14.08.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

A r s y e t i m

Ankuesit Skender Beqiri, në pozitën Inspektor i Arsimit në Inspektoratin e Arsimit-Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me Vendimin e datës 02.02.2017 me nr.ref: 2-501 të nxjerrë nga U.d Sekretari i Përgjithshëm i U.d Sekretari i Përgjithshëm i, i është përfunduar marrëdhënia e punës me datën 21.10.2017 për shkak të arritjes së moshës së pensionimit.

U.d Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, me datën 02.02.2017 ka nxjerr Vendimin me numër 2-501, me të cilin ankuesit i ka bërë pagesën në shumë prej një (1) page mujore të njëhershëm në vlerën e pagës së fundit.

Ankuesi me datën 31.07.2018 ka parashtruar kërkesë/ankesë tek Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, dhe tek U.d Sekretari i Përgjithshëm qe ti behet kompensimi i 3 pagave mujore për pensionim, si dhe 3 pagave jubilare gjithsejte ne lartësinë prej 3180 euro.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i MASHT, me datën 14.08.2018 ka nxjerr

Vendimi me Nr.2-1K/3535, me të cilin i refuzohet si e pa afatshme ankesa e ankuesit.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimi me Nr.2-1K/3535 të datës 14.08.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të MASHT, të cilin vendim e ka pranuar me datën 27.09.2018, më datë 15.10.2018 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5978/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 17.10.2018 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit në MASHT. Më datë 29.10.2018, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga MASHT me provat e bashkangjitura faqe 1/17.

Administrimi i Provave-Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 5978/2018 e datës 15.10.2018 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopja e letërnjoftimit e Skender Beqirit; Vendimi me Nr.2-1K/3535 i datës 14.08.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Kopja e librezës se punës e z. Beqiri; Vërtetim i përvojës se punës se z. Beqiri, lëshuar nga MASHT me datën 06.03.2017; Vërtetim i përvojës se punës se z. Beqiri, lëshuar nga Komuna e Ferizajt me datën 16.04.2003; Kërkesa e Këshillit për përgjigjen ne ankesën e ankuesit me numër protokolli 6109/2018 e datës 17.10.2018, dhe përgjigje në ankesë e datës 29.10.2018 bashkë me shkresat e lëndës (17 faqe).

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit Skender Beqiri, ***është e pa bazuar sepse:***

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se z. Skender Beqirit me Vendimin e datës 02.02.2017 me numër reference 2-501 të nxjerrë nga U.d Sekretari i Përgjithshëm i MASHT, i është përfunduar marrëdhënia e punës nga data 21.10.2017 për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Po ashtu me datën 02.02.2017 U.d Sekretari i Përgjithshëm i MASHT ka nxjerr Vendimin me numër 2-501, me të cilin ankuesit i ka bërë pagesën në shumë prej një (1) page mujore të njëhershëm në vlerën e pagës së fundit, ndërsa ankuesi me datën 31.07.2018 ka parashtruar kërkesë/ankesë tek Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, dhe tek U.d Sekretari i Përgjithshëm, e që është jashtë afatit prej 30 ditësh siç parashihet me dispozitat e nenit 127 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: ***"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ"***, si dhe jashtë afatit të paraparë me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, i cili përcakton se: ***"Ankesa duhet të paraqitet brenda afati prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës".***

Mbi bazë të kësaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në MASHT, kur ka vendos me Vendimin Nr.2-1K/3535 të datës 14.08.2018, me te cilën e ka refuzuar si te pa afatshme ankesën e ankuesit, ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjedhjes së Kontesteve dhe Ankesave në Shërbimin Civil, duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe juridike.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në diapozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, Skender Beqiri;
- Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MASHT;
- Arkivit të KPMSHCK- së

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A nr.651/2018;

Hajzer Salihu
Kryetar i Kolegjit

Sabile Avdyli
Procesmbajtëse